


# KORNIZA ORIGJINALE E DIALOGUT POLITIK

**BODO WEBER DHE AGRON BAJRAMI**


Berlin–Prishtinë  
maj 2018



# KORNIZA ORIGJINALE E DIALOGUT POLITIK

BODO WEBER DHE AGRON BAJRAMI

Berlin–Prishtinë  
maj 2018



- 1 → Korniza Origjinale e Dialogut Politik
- 2 → Njohja e realitetit: Çështja e njohjes së Kosovës nga Serbia
- 3 → Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në BE dhe OKB
- 4 → Mbrojtja etnike kolektive si mjet i (jo)Integrimit: Asociacioni / Bashkësia e Komunave me shumicë serbe
- 5 → Çfarë mund t'i ofrojë Kosova Serbisë? Çështjet dypalëshe në negociatat mbi një Marrëveshje Gjithëpërfshirëse

Autorët:  
**Bodo Weber dhe Agron Bajrami**

Përkthimi në shqip:  
**Agron Bajrami**

Redaktimi:  
**Kirsty Campbell; DPC Editorial Committee (anglisht)**

**Berlin - Prishtinë**  
**maj 2018**

Seria e shënimeve të politikave është pjesë e projektit për dialog dhe avokim "Fuqizimi i perspektivës së Kosovës – Negociatat për një Marrëveshje gjithëpërfshirëse finale mes Kosovës dhe Serbisë", organizuar bashkërisht nga Këshilli për Politika të Demokratizimit (DPC, Berlin), Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS, Prishtinë) dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS, Prishtinë), përkrahur nga KFOS-i.

06  
PARATHËNIE

09  
HYRJJE

12  
MARRËVESHJA  
NGA ANA  
E BE-SË

17  
MARRËVESHJA  
NGA ANA E  
KOSOVËS

23  
KONKLUZAT

07  
PËRMBLEDHJA  
EKZEKUTIVE

11  
KORNIZA  
ORIGJINALE  
E DIALOGUT  
POLITIK

15  
MARRËVESHJA  
NGA ANA E  
SERBISË

20  
MARRËVESHJA  
GJITHËPËRFSHIRËSE:  
FAZA PARA  
NEGOCIATAVE

# PARATHËNIE

Ky shënim është i pari nga seria e shënimeve të politikave, të cilat do të botohen gjatë këtij viti, e që trajtojnë të ashtuquajturën “fazë e re” në dialogun politik të udhëhequr nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë. Në mënyrë specifike, kjo seri do të adresojë negociatat për një marrëveshje finale, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obliguese për normalizim të plotë të marrëdhënieve mes të dyja vendeve. Ajo do të mbulojë aspektet dhe elementet më të rëndësishme të një marrëveshjeje potenciale të së ardhmes nga perspektiva e Kosovës si dhe ajo ndërkombëtare, si pjesë e një projekti më të gjerë të dialogut dhe avokimit të titulluar “Fuqizimi i perspektivës së Kosovës - negociatat për një Marrëveshje gjithëpërfshirëse finale mes Kosovës dhe Serbisë” të organizuar nga Këshilli për Politika të Demokratizimit (DPC, Berlin), Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS; që të dyja me seli në Prishtinë).

Përmes një shumëllojshmërie aktiviteteve, projekti synon të lehtësojë një proces dialogu mes politikëbërësve të Kosovës, aktorëve nga shoqëria civile dhe zyrtarëve perëndimorë rreth pozicionit të Kosovës në negociatat që afrohen. Në vend se të ofrojë rekomandime të gatshme për pozicionin negociues të Kosovës, shënimet e politikave kanë për qëllim të shërbejnë si një katalist për debat dhe dialog intensiv dhe të frytshëm. Duke përdorur këtë qasje, autorët, sikur edhe organizatorët e gjithë projektit, synojnë të ndihmojnë tejkalimin e kufizimeve strukturore që ndërlidhen me negociatat që vijnë për një marrëveshje gjithëpërfshirëse finale. Objektiva e fundit e tyre është të kontribuojnë për një zgjidhje të qëndrueshme të kontestit Kosovë-Serbi, që do t’i jepte fund statusit të të dyja vendeve si shtete të papërfunduara, dhe do të krijonte një parakusht të rëndësishëm për një paqe afatgjate në rajon dhe për një transformim të qëndrueshëm demokratik edhe të Kosovës, edhe të Serbisë.

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Enxitur nga dhuna në Kosovën veriore gjatë verës së vitit 2011, kancelarja gjermane, Angela Merkel, e mori në dorë lidhësin e BE-së rreth kontestit Kosovë-Serbi. Kjo paraqiste një faktor që ndryshoi rrjedhën në përpjekjet e zgjatura të Perëndimit për promovimin e një marrëveshjeje. Një zgjidhje e kontestit rreth statusit, duke përdorur një qasje klasike të ndërmjetësimit në konflikt kishte dështuar në vitin 2007 me kolapsin e negociatave të Treshes (negociatat e udhëhequra nga SHBA-ja/BE-ja/Rusia) dhe refuzimin nga ana e Serbisë të planit të Ahtisaarit. Kjo ndodhi për shkak të politikës ‘virtuale’ njëdekadëshe të Beogradit ndaj Kosovës, e cila ishte reduktuar në një insistim për statusin e Kosovës si pjesë e Serbisë, ndërsa nuk e pranonte seriozisht shumicën shqiptare të popullatës si qytetarë të barabartë. Kjo e la formalizimin e faktit se Serbia efektivisht e ka humbur Kosovën përmes shpalljes së pavarësisë së saj, si të vetmen zgjidhje potencialisht të zbatueshme dhe të qëndrueshme për kontestin afatgjatë të statusit.

Merkel, e përkrahur fuqishëm nga Britania e Madhe dhe SHBA-ja, në mënyrë eksplicite e ndërlidhi njohjen e Kosovës së pavarur nga Serbia me aspiratat e Beogradit për anëtarësim në BE, gjatë konferencës së saj për shtyp në gusht të vitit 2011 me presidentin e atëhershëm serb, Boris Tadiq. Duke bërë kështu, ajo detyroi një ndryshim në marrëdhëniet e BE-së me Serbinë, të cilat deri atëherë ishin përcaktuar nga një politikë po aq

‘virtuale’ serbe “edhe BE-ja, edhe Kosova”, drejt një politike më pragmatike dhe më realiste. Kjo i definoi kornizën dhe synimet finale të dialogut të mëpastajmë politik: integritetin territorial, sovranitetin dhe ushtrimin e plotë të subjektivitetit ndërkombëtar për Kosovën, sikur edhe zhvillimin e marrëdhënieve normale bilaterale mes Serbisë dhe Kosovës. Kjo kornizë është përforcuar dhe definuar në masë të madhe nga ‘plani shtatë-pikësh’ i grupit Schockenhoff të deputetëve gjermanë nga shtatori i vitit 2012, Marrëveshja e prillit 2013, dhe aspektet e ndërlidhura me dialog nga Korniza negociuese për anëtarësim e BE-së me Serbinë, nga viti 2014.

Dialogu politik ka përfshirë një koncesion të qenësishëm për Beogradin: qasja shtesë kishte për qëllim të lehtësojë një përshtatje të brendshme të politikës së Qeverisë së Serbisë dhe diskursit publik rreth pavarësisë së Kosovës, në mënyrë që t’i lejohet përparimi rrugës së Serbisë drejt anëtarësimit në BE. Në vitin 2013, zyrtarët serbë u përfshinë në mënyrë konstruktive në dialog dhe e ndryshuan diskursin e tyre ndaj Kosovës për një shkallë të paprecedentë. Megjithatë, BE-ja e lejoi së pari Serbinë, e më pas edhe Kosovën që vazhdimisht të shtyjnë zbatimin real të hapave të dakorduar. Andaj, Beogradi e shpenzoi mundësinë e ofruar nga procesi, duke e ringjallur në vend të kësaj një shpresë se mund t’i shmangët pranimit të pavarësisë së Kosovës.

Prej atëherë, qasja shtesë e BE-së është njollosur nga një pezëm çdo herë e më toksik, pa një zgjidhje të parashikueshme. “Faza e re” është shpallur në korrik të vitit 2017, duke i vënë kornizën negociatave për një marrëveshje finale, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme për normalizim të plotë mes Kosovës dhe Serbisë, si i vetmi opsion i qëndrueshëm. Megjithatë, gati një vit më vonë, kjo fazë mbetet e panisur, gjë që lejon një shmangie të mëtutjeshme nga kursi në Beograd, Bruksel dhe Prishtinë. Serbia, posaçërisht, po përfshihet në shtrembërim intensiv politik dhe publik, duke evokuar “zgjidhje” sikur që janë ndarja apo këmbimi i territoreve, të cilat tërësisht bien jashtë vijave të kuqe të vendosura nga kryeqytetet kryesore të BE-së. Kryenegociatorët e BE-së, Federica Mogherini dhe ekipi i saj, duket se kanë mungesë të kuptimit që roli i tyre qëndron në mbajtjen dhe mbrojtjen e vijave të kuqe dhe jo thjesht në “lehtësim”. Raporte të ndryshme mediale kanë ngritur pyetje nëse Prishtina mund të jetë e hapur ndaj lobimit për ndarje që e bën Beogradin.

Për një rezultat të suksesshëm të negociatave, për një marrëveshje gjithëpërfshirëse që do të vendoste skenën, për një të ardhme paqësore dhe demokratike për Kosovën dhe Serbinë, bashkë-ekzistenca e tyre bashkëpunuese dhe me dobi të ndërsjella, dhe të ardhmen e rajonit të gjerë, është qenësore që BE-ja (dhe SHBA-ja) ta theksojnë në mënyrë eksplicite kornizën dhe synimet origjinale të dialogut. Është po aq e rëndësishme që Prishtina t’i përmbahet kushteve sipas të cilave fillimisht ka hyrë në dialog.



“Faza e re” është shpallur në korrik të vitit 2017, duke i vënë kornizën negociatave për një marrëveshje finale, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme për normalizim të plotë mes Kosovës dhe Serbisë, si i vetmi opsion i qëndrueshëm

## HYRJE

Në korrik të vitit 2017, palët në dialogun e udhëhequr nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë bënë publike “fazën e re” të negociatave, që synonte arritjen e një marrëveshjeje finale, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obliguese për normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo shënoi fillimin e një periudhe të përkohshme para nisjes së negociatave të vërteta, e cila deri më tani (maj 2018) ka zgjatur pak më pak se një vit. Meqë BE-ja nuk e ka bërë publike një kornizë për negociatave, e as vijat e kuqe që ajo do t’i definojë, ndërsa palët rajonale, posaçërisht Beogradi zyrtar, janë përfshirë në shtrembërim masiv politik, ekziston një pasiguri dhe konfuzion i thellë në Kosovë (por edhe në Serbi dhe në Perëndim) rreth motivit të ri prapa dëshirës për të kërcyer në pikën përfundimtare të dialogut.

Këto i janë shtuar pasigurisë mbizotëruese rreth asaj se cilat janë objektivat përfundimtare të dialogut. Dalja në një fazë të re në dialog nënkuptonte se njohja implicite të cilën e kërkonte qasja e mëparshme graduale e normalizimit, përmes një serie marrëveshjesh prej të cilave Marrëveshja e prillit 2013 fillimisht ishte planifikuar të jetë e para, kishte dështuar. Vonesat e pafundme në zbatimin e Marrëveshjes së prillit, natyra e mbyllur e negociatave të Brukselit, sikur edhe ndryshimi në retorikën e Beogradit, që të gjitha këto errësuan synimet përfundimtare të dialogut. E kombinuar me përfitime shumë pak të dukshme


për vendin e tyre, kjo ka çuar në një rënie të shpejtë të përkrahjes për dialogun në mesin e qytetarëve të Kosovës.<sup>1</sup>

Nga perspektiva e aktorëve kryesorë politikë brenda BE-së dhe Perëndimit në përgjithësi, kushtet themelore dhe synimet përfundimtare të dialogut mbeten të vlefshme, andaj dhe të ngarkuara dhe obliguese edhe për Kosovën, edhe për Serbinë. Marrëveshja origjinale doli pas një numri zhvillimesh domethënëse. Në korrik të vitit 2010, rasti i Qeverisë serbe para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) dështoi, kur shpalljen e pavarësisë së Kosovës të vitit 2008, të përkrahur nga Perëndimi, vendimi nuk e deklaroi të jetë shkelje e ligjit ndërkombëtar. Beogradi më pas bëri presion për një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që do të dënonte pavarësinë e Kosovës. Më pas, qeveritë e Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe e sinjalizuan Beogradin, për herë të parë në mënyrë të hapur, se nëse dëshiron të mbajë aspiratat e veta për integrim në BE, do të duhej ta pranonte realitetin e një Kosove të pavarur. Kundër-shtytja rezultoi me vendosjen e një dialogu teknik, në shkurt të vitit 2011. Trazirat e dhunshme në veri të Kosovës në verën e vitit 2011 nxitën kancelaren gjermane, Angela Merkel, të marrë në dorë lidhësin e BE-së rreth kontestit Kosovë-Serbi. Marrë bashkërisht, këto ngjarje shënuan çastin vendimtar në këtë proces. Vendosja e pranimit të Kosovës së pavarur,

<sup>1</sup> Shih shënimet për perceptimin qytetar të dialogut në “Barometri Kosovar i Sigurisë. Edicion Special: Perceptimi Publik për Politikën e Jashtme të Kosovës dhe Dialogun me Serbinë”, *Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë*, Prishtinë, shkurt 2018, e qasshme në: [http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-2017-Politika\\_e\\_Jashtme\\_182137.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-2017-Politika_e_Jashtme_182137.pdf)

territorialisht integrale si një kusht eksplicit për perspektivën e Serbisë për anëtarësim në BE i jep fund politikës mbipartiake të Serbisë edhe BE-ja edhe Kosova dhe vendos kornizën për dialogun e ardhshëm politik. Marrëveshja e prillit 2013 sikur edhe Korniza negociuese për anëtarësimin e BE-së me Serbinë nga viti 2014, d.m.th. përmbajtja e saj dhe mekanizmat e ndërlidhur me dialogun, e përshkruajnë këtë kornizë në detaje.

Ky shënim synon të theksojë kushtet e marrëveshjes origjinale për dialog, që janë relevante për negociatat e ardhshme për një marrëveshje gjithëpërfshirëse finale. Seksioni i parë vështron zhvillimin e dialogut origjinal dhe kushtet me të cilat Kosova, por edhe Serbia, hynë në këtë proces. Seksioni i dytë i krahason ato kushte me retorikën dhe sjelljen e partnerëve të dialogut gjatë periudhës së tanishme të përkohshme në fazën e re të dialogut. Seksioni final nxjerr konkluzat për negociatat e ardhshme rreth një marrëveshjeje finale, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish obliguese mes Kosovës dhe Serbisë për normalizim të plotë të marrëdhënieve.



# KORNIZA ORIGJINALE E DIALOGUT POLITIK

# MARRËVESHJA NGA ANA E BE-së

Aktorët udhëheqës të BE-së për kohë të gjatë i janë shmangur ngarkimit të marrëdhënieve me Serbinë, duke e konfrontuar Qeverinë e saj ballë për ballë me mospajtimin e tyre rreth qëndrimeve të Beogradit ndaj statusit të Kosovës. Përplasjet e dhunshme mes serbëve të Kosovës dhe së pari Policisë së Kosovës, e më pas edhe trupave të KFOR-it në Kosovën veriore, në verën e vitit 2011, i kanë bindur shtetet anëtare të BE-së për nevojën që të ndryshojnë këtë qasje. Kjo edhe e vendosi skenën për dialogun politik. Tensionet pararendëse në marrëdhëniet BE-Serbi pas vendimit të GjND-së nga korriku i vitit 2010 kontribuan në ndryshimin e kësaj politike. Gjatë vizitës së tij në Beograd, në shtator 2010, sekretari i Jashtëm britanik i atëhershëm, William Hague, sinjalizoi një fund për politikën “edhe BE edhe Kosova” të Qeverisë serbe - që përfshinte lobim tek shtetet anëtare, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën - duke

vërejtur se që Serbia të hyjë në BE ajo ka nevojë për përkrahjen e 22 shteteve që e kanë njohur Kosovën, jo vetëm të atyre pesë që nuk e kanë njohur.<sup>2</sup>

Por ishte incidenti i verës së vitit 2011 ai që përfundimisht ia demonstroi kryeqyteteve të BE-së se politika e mbajtjes së *status quo-së* ishte bërë e paqëndrueshme. Marrja e lidershit nga kancelarja gjermane Merkel dhe Qeveria e saj, të përkrahur fuqishëm nga Britania e Madhe dhe SHBA-ja, ishte faktori ndryshues. Gjatë konferencës së famshme për gazetarë më 23 gusht 2011, me presidentin e atëhershëm serb, Boris Tadiq, Merkel vendosi katër pika që e definuan kornizën dhe rezultatin përfundimtar të dialogut të ardhshëm politik. Së pari, ajo iu referua rastit të Qipros si një mësim të mësuar në integrimin e BE-së. Së dyti, ajo theksoi nevojën që kontesti Ser-

2 “It would be good to withdraw resolution”, B92, shtator 3, 2010, e qasshme në: [https://www.b92.net/eng/insight/tvshows.php?yyyy=2010&mm=09&nav\\_id=69473](https://www.b92.net/eng/insight/tvshows.php?yyyy=2010&mm=09&nav_id=69473).

bi-Kosovë të trajtohet herët në procesin e lëvizjes së Serbisë drejt anëtarësimit, duke e njohur faktin se zgjidhja ishte një proces afatgjatë. Së treti, Merkel dy herë theksoi se “Gjermania e ka njohur Republikën e Kosovës” - duke përdorur emrin zyrtar të Kosovës, gjë që me Kushtetutë nuk është pranuar nga Serbia. Dhe së fundi, ajo prezantoi tri kushte me “zhbërjen e strukturave paralele” si kusht qendror,<sup>3</sup> duke e kushtëzuar kështu për herë të parë anëtarësimin në BE me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe transformimin e marrëdhënieve Serbi-Kosovë në marrëdhënie bilaterale, ndërshtetërore. Ministri i Jashtëm gjerman, Guido Westerwelle, gjatë një turneu në Mal të Zi dhe Kosovë, dy javë para udhëtimit të kancelares, tashmë kishte theksuar se “Gjermania nuk do të negociojë integritetin territorial të vendeve në rajon”, dhe dha indicie se ndarja territoriale e Kosovës nuk ishte në tavolinë.<sup>4</sup>

Në shtator 2012, pasi koalicioni i ri mes Partisë Progresive Serbe (SNS) dhe Partisë Socialiste të Serbisë (SPS) doli si fitues edhe në zgjedhjet presidenciale, edhe në ato parlamentare dhe në prag të nisjes së dialogut politik në Bruksel, grupi i ashtuquajtur Schöckenhoff - një grup i parlamentarëve gjermanë nga partitë CDU-CSU, i udhëhequr nga Andreas Schöckenhoff, asokohe bashkëkryesues i Grupit parlamentar konservator dhe aleat i afërt i kancelares Merkel - bëri publike planin shtatë-pikësh: një listë kushtesh për që Serbia duhet t’i përmbushë para se të le-

johe t’i nisë negociatat për anëtarësim.<sup>5</sup> Muajin e njëjtë, grupi Schöckenhoff vizitoi Beogradin, ku u takuan me zyrtarët e lartë të Qeverisë dhe ia parashtruan planin e tyre publikut të gjerë. Në qendër të planit shtatë-pikësh, që tashmë deri në një masë vendoste edhe kornizën për Marrëveshjen e prillit, ishin tri kushtet e kancelares Merkel nga muaji gusht. Kështu, kushti i pestë i Schöckenhoffit kërkonte “një proces të qëndrueshëm të zhbërjes së strukturave paralele të aparatit të sigurisë dhe administratës publike në Kosovën veriore, dhe të financimit të këtyre strukturave”<sup>6</sup>. Pika shtatë shkante përtej nisjes së negociatave për anëtarësim, dhe kërkonte për “një normalizim ligjërish të obligueshëm të marrëdhënieve me Kosovën, me perspektivën që Serbia dhe Kosova, si shtete anëtare të plota sipas traktateve të BE-së, të jenë të afta të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të përmbushin përgjegjësitë pavarësisht prej njëra-tjetrës”<sup>7</sup> që duhet zbatuar para se Serbia të finalizojë negociatat për anëtarësim.

Gjatë konferencës për shtyp të grupit Schöckenhoff, më tej theksoi se “çështja e kufijve të jashtëm të BE-së duhet të zgjidhet në momentin kur Serbia hyn në Union”<sup>8</sup>. Siç e shpjegoi një anëtar i grupit Schöckenhoff, gjatë takimeve të tyre zyrtare në Beograd dhe në vizitën e mëpastajme në Prishtinë, në shkurt të vitit 2013, deputetët e CDU-CSU-së qartë e shprehën se ata presin që rezultati final i dialogut të jetë: integritet i plotë territorial dhe sovranitet i Kosovës, ushtrimi i plotë i subjekti-

3 Dy kushtet tjera, bashkë me nisjen e zhbërjes së strukturave paralele të shtetit serb në teritorin e Kosovës, ishin përparimi në dialogun teknik, posapërisht në raport me menaxhimin e kufirit, dhe qasja për EULEX-in në veri. Merkel e prezantoi përmbushjen e këtyre kushteve si domsdoshmëri që Serbisë të ipet statusi i kandidatit. Shih transkriptin e konferencës për shtyp Tadiq-Merkel në: <https://www.bundeskanzlerin.de/ContentArchiv/DE/Archiv17/Mitschrift/Pressekonferenzen/2011/08/2011-08-23-pk-merkel-tadic.html>.

4 “Nemačka: Nema pregovora o granicama,” B92, gusht 9, 2011, e qasshme në: [https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2011&mm=08&dd=09&nav\\_id=530869](https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2011&mm=08&dd=09&nav_id=530869); “Merkel stellt Serbien Bedingungen,” FAZ, gusht 23, 2011, e qasshme në: <http://www.faz.net/aktuell/politik/europaeische-union/eu-kandidatenstatus-merkel-stellt-serbien-bedingungen-11108819.html>.

5 Bundestagu gjerman kërkohet të aprovoj çdo hap në integrimin në BE.

6 Andreas Schöckenhoff, “Expectations concerning Serbia with regard to the start of accession negotiations,” shtator 13, 2012.

7 Ibid.

8 Schöckenhoff, “Pressestatement: Erwartungen an Serbien für eine Aufnahme von EU-Beitrittsverhandlungen,” konferencë për shtyp, 13 shtator 2012, Beograd.

vitetit ndërkombëtar dhe normalizim i plotë i marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, si marrëdhënie bilaterale.<sup>9</sup>

Derisa Marrëveshja e prillit e vitit 2013 iu shmang qartësimin eksplisit të kornizës dhe synimeve të dialogut, edhe për shkak se qasja e “ambiguitetit kreativ” nga EEAS-i e la karakterin ligjor të dokumentit të padefinuar, ajo i ndoqi pikat e vendosura paraprakisht. Kështu, policia në Kosovën veriore do të jetë “e integruar në kornizën e Policisë së Kosovës”, gjyqësia në “kornizën ligjore të Kosovës”, dhe komunat do të vendosen “në pajtim me ligjin e Kosovës”. Njëkohësisht, Serbia u zotua se nuk do ta bllokojë rrugën e Kosovës drejt BE-së, duke ditur se BE-ja pranon për anëtare vetëm shtete të pavarura.<sup>10</sup>

Korniza e BE-së për negociata për anëtarësim me Serbinë, në janar të vitit 2014, vendosi kushtet e theksuara dhe synimet finale të dialogut politik në një përmasë më të madhe sesa Marrëveshja e prillit.

Korniza e definoi çështjen e Kosovës si një prej parakushteve kyç për anëtarësim, të barabartë për nga relevanca me sundimin e ligjit, duke e përshkruar objektivin e saj primar si “normalizim gjithëpërfshirës i marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, në formën e një marrëveshjeje ligjorisht obligative... me perspektivën që të dyja të jenë në mundësi të ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre”. Kjo do të sigurohej duke e kthyer një kapitull shtesë të negociimit (Kapitulli 35) në kapitull për Kosovën. Pjesët e kornizës që ndërlidhen me dialogun bartnin shenjën e qeverive të Gjermanisë

dhe të Britanisë së Madhe, të cilat qartësuan pozitat e tyre gjatë negociatave të brendshme të BE-së rreth versionit final të dokumentit në një non-paper të përbashkët në vjeshtën e vitit 2013. Përveç Kapitullit 35, Berlioni dhe Londra theksuan:

“kushtëzimi rreth normalizimit duhet të përçohet nëpër secilin Kapitull të negociatave... Kjo do të sigurojë që normalizimi adresohet në të gjithë kapitujt ku ka relevancë rreth Kosovës”.

Neni 38 i kornizës negociuese reflekton tërësisht këtë pikë:

“në të gjitha sferat e *acquis*, Serbia duhet të sigurohet se pozicioni i saj rreth statusit të Kosovës nuk krijon asnjë pengesë apo ndërhyrje me zbatimin e *acquis* nga Serbia. Si pjesë e përpjekjeve të saj për t’u vënë në vijë me *acquis* të BE-së, Serbia posaçërisht do të sigurohet se legjislacioni i miratuar, përfshirë shtrirjen e saj gjeografike, nuk është në kundërshtim me normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Kosovën”<sup>11</sup>.

Në praktikë kjo kishte domethënie se Serbia, përmes përshtatjes së legjislacionit të saj me *acquis* të BE-së në fushat e mbuluara nga 34 kapitujt e parë të negociatave për anëtarësim, ishte e **obliguar** të përjashtojë territorin e Kosovës nga legjislacioni dhe institucionet e saj shtetërore.

9 Intervistë me një ish-anëtar të grupit Schockenhoff, Berlin, maj 2018.

10 “First agreement of principles governing the normalization of relations,” Bruksel, prill 19, 2013, e qasshme në: <http://www.rts.rs/upload/storyBoxFileData/2013/04/20/3224318/Originalni%20tekst%20Predloga%20sporazuma.pdf>.

11 Korniza Negociuese. POZICIONI I PËRGJITHSHËM I BE-së. Takimi ministror në hapje të Konferencës Ndërqeveritare për Anëtarësim, 9 janar, 2014, e qasshme në: <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?l=EN&t=PDF&gc=true&sc=false&f=AD%201%202014%20INIT>

of Serbia to the European Union (Brussels, 21 January 2014)

# MARRËVESHJA NGA ANA E SERBISË

Në Serbi, bëra publike nga kancelarja Merkel e kushteve vendimtare që ndërlidhen me Kosovën për integrimin e vendit në BE, nga gushti i vitit 2011, nuk la hapësirë për konfuzion. Tomislav Nikoliq, asokohe president i partisë më të madhe opozitare, SNS, dha një deklaratë publike ku e konsideron përmendjen nga BE-ja të njohjes së pavarësisë së Kosovës si një kusht për anëtarësim. Duke iu përgjigjur, zëvendëskryeministri Ivica Dačić tha:

“natyrisht që nuk e kushtëzon (anëtarësimin me njohjen e Kosovës). Por do të kërkojë heqjen e institucioneve tona në veri, njohjen e pikave doganore si kufij dhe kështu me radhë... dhe çka është kjo?”<sup>12</sup>.

Një vit më vonë, pas fitores zgjedhore të SNS-së, presidenti i ri i partisë (dhe ministër i Mbrojtjes) Aleksandar Vučić, deklaroi se qeveria e udhëhequr

nga SN do të ketë një politikë të “mosnjohjes së Kosovës”. Njëkohësisht, ai theksoi se partia e tij synon të zbatojë marrëveshjet ekzistuese nga dialogu Serbi-Kosovë<sup>13</sup>.

Me gjithë këtë, duke vendosur një precedent historik, kryeministri i ri Ivica Dačić, u takua me homologun kosovar, Hashim Thaçi, në tetor 2012, për një hapje formale të dialogut politik në Bruksel. Draft-platforma e Qeverisë së Serbisë për negociimin e një marrëveshjeje me Prishtinën, e dhjetorit 2012, përfaqëson përpjekjen e fundit për të mbajtur pozicionin tradicional nationalist ndaj Kosovës si një krahinë e Serbisë, derisa njëkohësisht pranon kërkesën e BE-së për “zhbërje të strukturave paralele”. Kështu platforma insistonte se pika fillestare e negociatave me Prishtinën është që “Republika e Serbisë nuk e njeh dhe kurrë nuk do ta njohë shpalljen e njëanshme të ‘pavarësisë’ së Kosovës”. Në të

12 Sipas: *Beta*, 2 shtator, 2011.

13 “Vučić: Naš posao je da ne priznamo Kosovo,” *Deutsche Welle*, 1 korrik, 2012, e qasshme në: <http://www.dw.com/sr/vu%20C4%8Di%20C4%87-na%20C5%A1-posao-je-da-ne-priznamo-kosovo/a-16063744>



njëjtën kohë, dokumenti propozon që Armata e Serbisë, bashkë me Armatën e Shqipërisë dhe trupat e BE-së, të shërbejnë si “garantues të sigurisë dhe statusit të demilitarizuar të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë”<sup>14</sup>.

Me gjithë insistimin e vazhdueshëm të zyrtarëve të Serbisë për një politikë të mosnjohjes së Kosovës, vetëm pas disa javësh Qeveria ndryshoi pozicionin e saj ndaj Kosovës pothuajse tërësisht, duke e nënshkruar Marrëveshjen e prillit 2013, e cila efektivisht e filloi integrimin e veriut të Kosovës në Republikën e Kosovës. Ky ndryshim ishte vlerësuar nga disa ekspertë ligjorë serbë si *de facto* njohje e pavarësisë së Kosovës, nëse jo edhe njohje eksplicite *de jure*. Njëkohësisht, zyrtarët qeveritarë e zhvendosën diskursin publik drejt një pranimi të së vërtetës së pakëndshme në lidhje me humbjen e Kosovës. Në një artikull të shënuar për javoren NIN, të publikuar në mars të vitit 2013, kryeministri Daçiq zbuloi se Kosova ka qenë tabu për një dekadë, duke pranuar se:

“Ne po e gënjenim veten se Kosova është e jona dhe madje e bëjmë këtë gënjeshtër zyrtare në formën e Kushtetutës. Sot e njëjta Kushtetutë nuk na ndihmon. Presidenti i Serbisë nuk mund të udhëtojë në Kosovë, e as kryeministri, e as ministrat, e as policia, e as ushtria”<sup>15</sup>.

Në prag dhe menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së prillit, Daçiqi dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Qeverisë serbe theksuan se vetëm Armata e Serbisë mund ta kthejë Kosovën prapa nën sundimin serb, dhe se nuk ekziston një vullnet popullor për një veprim të tillë dhe se politika e Serbisë duhet të përqendrohet në “ruajtjen e një jete normale, të sigurt, dhe një të ardh-

meje të qartë” për serbët në Kosovë<sup>16</sup>. Duke reaguar ndaj një deklaratë të homologut të tij në Prishtinë, Thaçit, i cili tha se qëllimi i dialogut është një ulëse në OKB për Kosovën, Daçiqi la të kuptohet se nuk kishte më asnjë tabu, duke theksuar:

“Nëse pajtohem, çdo gjë është e mundur. Ne nuk po ikim nga kjo dhe ne kërkojmë një marrëveshje gjithëpërfshirëse, por që ai të marrë atë, ai po ashtu duhet të japë diçka. Ai kompromis duhet t’i kënaqë të dyja palët”<sup>17</sup>.

Hapja e negociatave për anëtarësim të Serbisë paraqiti hapin crucial të radhës në pranimin e realitetit nga ana e zyrtarëve serbë. Edhe pse Qeveria e Serbisë pa sukses ka lobuar kundër klauzolës që përcakton fushën gjeografike e që u shty përpara nga Gjermania dhe Britania e Madhe, ata megjithatë janë të obliguar prej saj. Gjatë vështimit bilateral të kapitujve për anëtarësim në fillim të negociatave për anëtarësim, për shembull, zyrtarët serbë paraqitën një listë me verërat që kanë origjinë Serbinë brenda kapitullit për bujqësi. Lista po ashtu përfshinte edhe një verë nga Kosova. Beogradit iu kërkua nga Komisioni Evropian që ta heqë atë verë nga lista dhe ata u nënshtruan ndaj kësaj kërkesë pa asnjë ankim<sup>18</sup>. Por, në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe kishte edhe vonesa në rritje, në zbatimin e Marrëveshjes së prillit, që u shoqëruan me përpjekjet e zyrtarëve qeveritarë që të zhvendosin narrativën e dialogut rreth Kosovës larg nga korniza e vet fillestare. Kështu, Qeveria e Serbisë e fshehu klauzolën gjeografike nga publiku i saj dhe çdo herë e më tepër insistonte se Marrëveshja e prillit ishte “neutrale ndaj statusit” - një deklaratë kjo e padëgjuar në kohën menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes.

14 Non-paper i Qeverisë serbe, dhjetor 2012.

15 Ivica Daçiq, „Dinđić je priča o Srbiji“, *NIN*, 7 mars, 2013.

16 Ibid.

17 “Dačić: Ne nudimo Kosovo mesto u UN,” *Mondo.rs*, 15 janar, 2018, e qasshme në: <http://mondo.rs/a274935/Info/Srbija/Dacic-Ne-nudimo-Kosovo-mesto-u-UN.html>.

18 Intervistë me zyrtarë të BE-së, Bruksel 2015.

# MARRËVESHJA NGA ANA E KOSOVËS

Deklaratat e kancelares Merkel, nga gushti 2011 në Beograd, u pranuan në Kosovë si përkrahje direkte për sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Insistimi gjerman që Serbia të zhbëjë strukturat e saja paralele në Kosovën veriore dhe që ndarja nuk ishte e pranueshme u perceptua si një sinjal që Berlino po e qartësonte cakun e dialogut (asokohe ende teknik), i cili tashmë ishte në krizë.<sup>19</sup>

Deklaratat e kancelares Merkel ishin po ashtu konsistente me ato që zyrtarët kosovarë kishin dëgjuar më herët nga ministri i Jashtëm gjerman, Guido Westerwelle<sup>20</sup>. Ishte vetë Westerwelle, i cili një vit më herët, e bëri të qartë për Kosovën se Berli-

ni e konsideron çështjen e ndryshimit të kufijve të mbyllur.<sup>21</sup>

Një tjetër pikë që e bëri përfshirjen gjermane të jetë kritike ishte fakti se, në atë kohë, KFOR-i udhëhoqej nga gjenerali gjerman, Erhard Buhler, trupat e të cilit u zënë në mes të krizës së korrikut 2011 në veri të Kosovës. Sipas gjeneralit Buhler, çështjet e rëndësishme për Kosovën ishin: “Kush e kontrollon Kosovën veriore? Kush qeveris me kufijtë dhe doganat?” Tutje, gjenerali Buhler bëri thirrje që BE-ja të ndërhyjë dhe të zgjidhë krizën, duke thënë: “Vetëm Bashkimi Evropian mund t’i udhëhojë këto negociata”.<sup>22</sup>

19 Një muaj më herët, si pasojë e dështimit të arritjes së një marrëveshjeje me Serbinë rreth vulave doganore, qeveria e Kosovës dërgoi njësitet e policisë special në veri të vendit, me urdhërat që të marrin kontrollin e dy pikave kufitare me Serbinë. Kjo e shoqëroi një krizë që ngriti tenzionet në veri, dhe ndali procesin e dialogut.

20 Më 11 gusht, 2011, ministri i jashtëm gjerman Westerwelle vizitoi Kosovën si pjesë e truneut të tij rajonal në kuadër të të cilit ishte edhe në Kroaci dhe Mal të Zi.

21 Shih fjalimin e ministrit Westerwelle në Kuvendin e Kosovës, më 7 gusht, 2010, i qasshëm në: <https://www.auswaertiges-amt.de/en/Newsroom/100827-bm-pristina/232704>.

22 Shih intervistën e gjeneralit Buhler për *Der Spiegel*, botuar më 2 gusht, 2011: <http://www.spiegel.de/international/europe/peacekeeping-in->

Por, në korrik dhe gusht 2011, vetëm katër muaj pas nisjes së bisedimeve, dialogu i Brukselit dukej të jetë në krizë të thellë. Për këtë arsye, një kthim në tryezën e dialogut ishte njëra nga tri kërkesat që Merkel i bëri Tadiqit gjatë takimit në Beograd. Sipas një anëtarit të atëhershëm të ekipit të Kosovës për dialog, realiteti ishte se bisedimet e ndërmjetësuar nga BE-ja “po kolapsonin” dhe ishte vetëm intervenimi nga kancelarja gjermane ai që “i ktheu gjërat në binarë”.<sup>23</sup>

Në anën tjetër Kosova po përjetonte jo vetëm përkrahjen, por edhe presionin dhe kritikën, po ashtu. Në një deklaratë të lëshuar më 26 korrik 2011, Departamenti i Shtetit i SHBA-së tha se ndien keqardhje për përpjekjen kosovare “për të marrë kontrollin e pikave kufitare doganore në Kosovën veriore që nuk ishte e koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare”.<sup>24</sup> Edhe BE-ja reagoi, duke thënë se aksioni “nuk ishte ndihmesë”. Maja Kocijancic, një zëdhënëse për shëfën e atëhershme të Politikës së Jashtme të BE-së, Catherine Ashton, tha se “ne besojmë që operacioni i kryer natën e kaluar nga autoritetet e Kosovës nuk ishte ndihmesë. Ai u bë pa konsultim me bashkësinë ndërkombëtare, dhe BE-ja nuk pajtohet me të”.<sup>25</sup>

Në Kosovë, veprimet në veri u shqyrtuan nga ambasadorët e shteteve të Quintit<sup>26</sup>, të cilët kërkuan nga kryeministri Thaçi që në të ardhmen të koordinojë veprimet me EULEX-in, të ulë tensionet dhe të ripërkushtohet për dialogun e Brukselit.<sup>27</sup>



**“Tani Serbia më nuk do të jetë në pozicion që të inkurajojë të tjerët që të bllokojnë përpjekjet (e Kosovës) për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.**

HASHIM THAÇI, KRYEMINISTËR

Si rezultat, lidhshipi i Kosovës u shty të ripërqendrohet në procesin e dialogut me caqe të definuara qartë, që nënkuptonte se bisedimet duhet të vazhdojnë, por me garanci që integriteti territorial i Kosovës nuk do të vihet në pikëpyetje. Ky realitet u reflektua në deklaratat publike të përfaqësuesve të Kosovës, të cilët insistuan se dialogu nuk kishte alternativë, dhe se Prishtina ishte kundër “hapjes së pakos së Ahtisaarit”.<sup>28</sup>

Ndërsa Marrëveshja e prillit 2013 u prit me reagime të përziera në Kosovë. Në Bruksel, shkurt pas nënshkrimit të saj, kryeministri i atëhershëm Thaçi e lavdëroi si “*de jure* njohje e Kosovës nga Serbia”.<sup>29</sup> Pas kthimit në Prishtinë, Thaçi mbajti një konferencë për shtyp duke e lartësuar marrëveshjen si një dokument që e konfirmon “Kosovën si një shtet të

kosovo-the-situation-is-still-tense-a-781613.html.

23 Vlerësim nga një ish anëtar i ekipit të Kosovës në dialog, maj 2018.

24 Departamenti i Shtetit, 26 gusht, 2011, komunikatë për shtyp: <https://2009-2017.state.gov/r/pa/prs/ps/2011/07/169107.htm>.

25 Deklarate e Kocijancic për *Radio Free Europe*: <https://www.rferl.org/a/kosovo/24277093.html>.

26 Një grupim joformal i anëtarëve perëndimorë të Grupit të Kontaktit: SHBA, Britani e Madhe, Gjermani, Francë, dhe Itali.

27 Deklaratë e Quint-it nga korriku 2011, siç është raportuar në: “Thaçi dëgjon Quintin - pranon rekomandimet e tyre,” *Koha Ditore*, 31 gusht, 2011.

28 Reagimi i Ministrisë të Jashtme të Kosovës Enver Hoxhaj ndaj propozimit që veriu të ketë status të ngjashëm me Kataloninë në Spanjë, bërë nga shefi i Zyrës Civile Ndërkombëtare, Pieter Feith, dhënë në një intervistë për *EUObserver*: [https://www.denederlandsegronddet.nl/id/vislc9ngeizn/nieuës/rol\\_voor\\_eu\\_diplomatie\\_na\\_moord\\_in?ctx=vhsidnë5uoik&tab=1&start\\_tabo=360](https://www.denederlandsegronddet.nl/id/vislc9ngeizn/nieuës/rol_voor_eu_diplomatie_na_moord_in?ctx=vhsidnë5uoik&tab=1&start_tabo=360).

29 Deklaratë e Thaçit për media dhënë në Bruksel pas nënshkrimit të marrëveshjes, 19 prill, 2013.

pavarur, dhe Serbinë si një shtet të pavarur”.<sup>30</sup> Më pas, marrëveshja shpejt u dërgua në Kuvend për diskutim dhe mbështetje. Gjatë debatit parlamentar, Thaçi tha se marrëveshja “zyrtarisht i jep fund strukturave paralele” në Kosovë, se ajo siguron që serbët në veri do të integrohen në institucionet e Kosovës, “do të punojnë sipas rendit kushtetues dhe ligjeve të Kosovës, dhe do të jenë pjesë vetëm e zinxhirit komandues (të Kosovës)”. Ai, po ashtu, insistoi se marrëveshja siguronte që përpjekjet e Kosovës për anëtarësim në të gjitha organizatat ndërkombëtare nuk do të përballen me pengesa nga Serbia, duke thënë:

“Tani Serbia më nuk do të jetë në pozicion që të inkurajojë të tjerët që të bllokojnë përpjekjet (e Kosovës) për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Çdo përpjekje për të penguar anëtarësimin në organizata ndërkombëtare është shkelje e kësaj marrëveshje”.<sup>31</sup>

Marrëveshja shpejt u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës, me gjithë disa brenga të shprehura rreth Asociacionit të komunave me shumicë serbe – pikës më të rëndësishme të marrëveshjes.<sup>32</sup> Kishte një hezitim të përgjithshëm drejt Marrëveshjes së prillit, por shumica e deputetëve vendosën ta përkrahin procesin për shkak të përfshirjes së Perëndimit. Përfaqësuesit e LDK-së në Parlament shkuan aq larg sa thanë se ata e përkrahin marrëveshjen në parim për shkak se ajo ka “garancitë dhe përkrahjen e SHBA-së dhe të BE-së”. Ky sentiment demonstroi se në esencë marrëveshja u votua jo për shkak se u konsiderua me vlerë të madhe, por për shkak se shihej si e domosdoshme për përkrahjen e vazhdueshme perëndimore.<sup>33</sup>

E vetmja parti që plotësisht dhe publikisht e kundërshtoi marrëveshjen ishte Vetëvendosja me liderin e saj, Albin Kurti. Në një konferencë për gazetarë një ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes, Kurti tha se ajo “po e shkatërronte shtetndërtimin në Kosovë”, akuzoi kryeministrin Thaçi se po e “legjitimon prezencën e Serbisë në Kosovë” dhe tërhoqi vërejtjen se partia e tij do të luftojë kundër marrëveshjes “brenda dhe jashtë Kuvendit”.<sup>34</sup>

Si konkluzë, koha mes intervenimit të vitit 2011 nga kancelarja Merkel dhe shkurt para nënshkrimit të Marrëveshjes së prillit 2013 është perceptuar në Kosovë si një periudhë e qartësisë së shtuar në procesin e dialogut. Derisa kishte të tillë që kundërshtuan dhe kritikuan bisedimet, shumica besonin që dialogu ishte në rrugën e duhur, dhe e shihnin atë si një proces të fokusuar me një cak të qartë të sjelljes së normalizimit Kosovë-Serbi pa rihapur çështjen e statusit të Kosovës, apo vënë në pikëpyetje integritetin territorial të vendit.

Ky vështrim është përforcuar nga nisja e procesit të integritetit gradual të veriut të Kosovës në sistemin shtetëror të Kosovës. Megjithatë, vetë Marrëveshja e prillit, po ashtu, ka shqetësuar një pjesë të kësaj qartësie, posaçërisht me Asociacionin e komunave me shumicë serbe: kjo rrezikoi (dhe vazhdon ta rrezikojë) funksionalitetin e Kosovës dhe integritetin e saj, dhe e ktheu sovranitetin e saj sërish në një çështje debati më parë sesa një fakt të pranuar nga palët dhe të etabluar (edhe nëse zyrtarisht mbetet pa u njohur).

30 Konferencë për shtyp e Thaçit mbajtur në Prishtinë, më 20 prill, 2013.

31 Fjalimi i Thaçit para Kuvendit të Kosovës, 21 prill, 2013.

32 Kuvendi i Kosovës miratoi marrëveshjen me 89 vota pro, 5 kundër, and një abstenim. Deputetët e Vetëvendosjes u përpoqën të pengojnë votimin, por në fund dështuan.

33 Fjalimi i Ismet Beqirit, shefit të grupit parlamentar të LDK-së, në sesionin e Kuvendit para votimit, më 21 prill, 2013.

34 Konferenca për shtyp e Vetëvendosjes mbajtur më 20 April, 2013, siç është raportuar nga *Koha Ditore*, 21 prill, 2013.

# MARRËVESHJA GJITHËPËRFSHIRËSE: FAZA PARA NEGOCIATAVE

Krahasuar me qartësinë e kushteve origjinale të dialogut politik (korniza dhe synimet përfundimtare të tij), sjellja e palëve të ndryshme negociuese seriozisht i ka kërcënuar themelet e fazës së re të dialogut, prej se kjo fazë u bë publike.

Kjo është posaçërisht e vërtetë për zyrtarët në Beograd. Gjashtë muaj para publikimit, në janar 2017, i ashtuquajturit incidenti me tren demonstroi se zyrtarët serbë kanë bërë pothuajse një kthesë të plotë në retorikën e tyre ndaj Kosovës krahasuar me periudhën shkurt pas nënshkrimit të Marrëveshjes së prillit 2013 - edhe për shkak të mbishkrimit në tren “Kosova është Serbi”, të sponsorizuar nga Qeveria, edhe për shkak të kërcënimit të presidentit të atëhershëm serb, Tomislav Nikoliq, se do ta dërgojë ushtrinë në Kosovë.<sup>35</sup> Që nga vera e vitit 2017, Beogradi me konsistencë ka ndjekur këtë vijë në avokimin e vet të brendshëm dhe të jashtëm. Ky ndryshim më së miri demonstroi përpjekjet e zyrtarëve serbë që të eksploatojnë krizat në dialog, t’i ikin kornizës fillestare, dhe të testojnë vijat e kuqe të

vendosura qartë nga BE-ja (dhe SHBA-ja) në kohën para nisjes së negociatave për një marrëveshje gjithëpërfshirëse.

Presidenti Vuçiq ka mbetur vazhdimisht i paqartë rreth negociatave të ardhshme, sikur edhe rreth pozicionit të ardhshëm negociues të Beogradit. Megjithatë, në deklaratat e tij publike sikur edhe në takimet private me zyrtarët perëndimorë, ai është përpjekur ta shtyjë dialogun larg nga përmbajtja e tij e synuar - njohja politike nga Serbia e faktit se Kosova më nuk është pjesë e shtetit të saj - dhe ta riformulojë si pyetje për BE-në, SHBA-në dhe Prishtinën se çfarë koncesionesh duhet t’i jepen Serbisë.

Përveç kësaj, ai ka punuar në riformulimin e negociatave për marrëveshje gjithëpërfshirëse mes Kosovës dhe Serbisë, si negociata klasike mes dy palëve të barabarta për të gjetur një kompromis të mesëm mes pozicioneve të tyre fillestare.<sup>36</sup> Shpjegimi i Vuçiqit pas një takimi me kancelaren Merkel në Berlin, më 13 prill 2018, ofron një shembull të mirë:

“Nuk ka një zgjidhje të mirë për Kosovën dhe Metohinë për ne, por një kompromis nënkupton se që të dy (serbët dhe shqiptarët) do të jenë paksa të pakënaqur apo paksa të kënaqur”.<sup>37</sup>

Përpjekjet e Vuçiqit dhe zyrtarëve të tjerë të lartë qeveritarë për t’u larguar nga marrëveshja rreth dialogut është reflektuar edhe më tutje në të ashtuquajturin dialog i brendshëm, që ishte nisur nga presidenti serb në korrik 2017. Derisa korniza dhe synimet e dialogut të brendshëm mbeten të paqarta, që nga vjeshta e vitit 2017 rreth një dyzinë tryezash janë organizuar në Serbi, duke sjellë bashkë përfaqësuesit e shtetit dhe institucioneve të tjera publike që ishin pothuajse ekskluzivisht në listë të pagave të Qeverisë. Propozimet e tyre të ndryshme për një marrëveshje gjithëpërfshirëse reflektuan mendimin tradicional nationalist ndaj Kosovës, dhe në masë të madhe injoruan kornizën origjinale për dialogun politik.<sup>38</sup>

Në esencën e përpjekjeve të Beogradit për të zhvendosur negociatat e ardhshme larg nga korniza e vendosur, Vuçiqi dhe zyrtarët e tjerë shtetërorë janë përfshirë në avokim intensiv për një ndarje territoriale të Kosovës, ose në kthim për një koncesion politik (ulëse në OKB për Prishtinën), ose si pjesë e këmbimit të territoreve (veriu i Kosovës për Serbinë jugore, rajonin e Preshevës me shumicë shqiptare). Derisa presidenti serb i ka diskutuar hartat në takimet e mbyllura me zyrtarë të BE-së, ministri i Jashtëm Daçiq ka qenë më së shumti aktiv në paraqitjet publike. Gjatë një interviste dhënë në gusht 2017, ai prezantoi idenë e tij për demarkim të territoreve serbe dhe atyre shqiptare, si një zgjidhje e sugjeruar e përhershme për një konflikt

shumëshekullor mes serbëve dhe shqiptarëve, duke thënë:

“Po përpiqem të propozoj një zgjidhje afatgjate të bazuar në një kompromis historik dhe të drejtat etnike, që nënkupton vendosjen e kufijve mes asaj që është serbe dhe asaj që është shqiptare”.<sup>39</sup>

Ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, po ashtu u përpoq të japë një kornizë për një ndarje territoriale të Kosovës si pjesë e një pajtimi të gjerë historik mes serbëve dhe shqiptarëve, duke insistuar se “një demarkim i përhershëm dhe i siguruar i serbëve dhe shqiptarëve duhet të vendoset në Kosovë dhe Metohi”, duke sugjeruar madje që Tirana do të duhej të zëvendësonte Prishtinën si partner negociues i Beogradit.<sup>40</sup>

Ajo që edhe më shumë e minoi besimin në fazën e re të dialogut dhe potencialit të tij për të arritur marrëveshje gjithëpërfshirëse, është fakti që një shtrembërim i realitetit nga Beogradi nuk është përballur me rezistencë konsistente dhe aktive nga BE-ja dhe SHBA-ja, së paku jo publikisht. Privatist, disa qeveri kyç perëndimore i kanë dërguar Beogradit mesazhe të qarta se refuzimi i çfarëdo ndryshimi kufijsh mbetet një vijë e kuqe e fuqishme, e pandryshuar.

E megjithatë, ka pasur indicie që kryenegociatorja e BE-së në dialog, Federica Mogherini, dhe ekipi i saj nuk e shohin funksionin e tyre si dikush që vendos vija të kuqe që kanë definuar kornizën origjinale të dialogut politik. Në vend të kësaj, ata duket se e marrin rolin e tyre si “lehtësues” në kuptimin formal.

35 “Nikolić: Srbija će poslati vojsku na Kosovo ako budu ubijani Srbi,” *Radio Slobodna Evropa*, 15 janar, 2017, e qasshme në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/28234504.html>.

36 Intervista me zyrtarë perëndimorë, 2017-18.

37 “Vučić: Za nas nema dobrog rešenja za Kosmet, Merkel shvata šta za nas znači KiM,” *Večernje novosti*, 13 prill, 2018, e qasshme në: <http://www.novosti.rs/vesti/naslovna/politika/aktuelno.289.html:721924-Vucic-Kancelarka-smatra-vaznim-da-nasa-zemlja-bude-na-samitu-u-Sofiji-Merkel-Srbija-je-kljucna-zemlja-u-regionu-VIDEO>.

38 Shih faqen zyrtare të dialogut të brendshëm: <http://unutrasnjidijalog.gov.rs/index.php>.

39 “Razgraničenje trajno rešenje za konflikt Srba i Albanaca,” *Politika*, 15 gusht, 2017, e qasshme në: <http://www.politika.rs/sr/clanak/386987/Razgranicenje-trajno-resenje-za-konflikt-Srba-i-Albanaca>.

40 <http://unutrasnjidijalog.gov.rs/v017.php>.

Greg Delawie, ambasadori i SHBA-së në Kosovë, ka dhënë një deklaratë të rrallë publike kundër çdo lloj ndryshimi të kufijve.<sup>41</sup> Më i zëshmi ka qenë tashmë ish-ministri i Jashtëm gjerman, Sigmar Gabriel, në deklaratën e tij në largim nga detyra, gjatë udhëtimit të tij në Ballkanin Perëndimor, në shkurt 2018. Pas vizitës së tij në Beograd, në një konferencë për gazetarë në Prishtinë me kryeministrin Ramush Haradinaj, Gabriel bëri atë që duhet të jetë deklarata më e sinqertë rreth synimeve përfundimtare të dialogut prej se ka nisur ky proces:

“Nëse Serbia dëshiron të lëvizë drejt BE-së, ndërtimi i sundimit të ligjit është kushti primar. Por, natyrisht, i tillë është edhe pranimi i pavarësisë së Kosovës. Ky është kusht qendror për të ecur rrugës përpara”.<sup>42</sup>

Me Perëndimin, posaçërisht BE-në, që dërgon sinjale të përziera rreth vlefshmërisë së kornizës origjinale të dialogut dhe vijave të saj të kuqe, ka pasur raporte që Qeveria e Kosovës mund të jetë e hapur për pranimin e lobimit të Beogradit për një ndarje. Në janar 2018, shefi i stafit të presidentit Thaçi, Bekim Çollaku, reagoi ndaj raporteve mediale rreth bisedimeve të supozuara mes presidentit Thaçi, kryeministrit shqiptar, Edi Rama, dhe ministrit të Jashtëm grek, Nikolaos Kotzias, për ndryshim të kufijve, duke insistuar se:

“Pozicioni i presidentit të Republikës së Kosovës mbetet i qartë: Kosova është një shtet i pavarur dhe sovran, dhe kufijtë e saj janë të njohur ndërkombëtarisht”.

41 <https://xk.usembassy.gov/ambassador-delawies-interview-sporazum/>.

42 “Sigmar Gabriel tells Serbia it must accept Kosovo’s independence to join EU,” *Deutsche Welle*, 15 shkurt, 2018, e qasshme në: <http://www.dw.com/en/sigmar-gabriel-tells-serbia-it-must-accept-kosovos-independence-to-join-eu/a-42593839>.

43 “Zyra e Presidentit Thaçi: Në këtë fazë është vetëm spekulim ideja e shkëmbimit të territoreve,” “Pse po mbahet sekret vendndodhja e Presidentit Thaçi?,” *Gazeta Express*, 10 dhe 11 janar, 2018, e qasshme në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/presidenca-ne-kete-faze-eshte-vetem-spekulim-ideja-e-shkembimit-te-territoreve-497852/>;

<http://www.gazetaexpress.com/lajme/pse-po-mbahet-sekret-vendndodhja-e-presidentit-thaci-498286/>.

44 “Thaçi publikisht distancohet nga idetë për ndarjen e Kosovës,” *Gazeta Express*, 12 shkurt, 2018, e qasshme në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/thaci-publikisht-distancohet-nga-idete-per-ndarjen-e-kosoves-498748/>.



**Nuk ka një zgjidhje të mirë për Kosovën dhe Metohinë për ne, por një kompromis nënkupton se që të dy (serbët dhe shqiptarët) do të jenë paksa të pakënaqur apo paksa të kënaqur”.**

ALEKSANDAR VUČIĆ, PRESIDENT I SERBISË

Disi në kundërthënie, ai shtoi: “Ne do të duhej ta prisnim fundin e dialogut. Çdo gjë tjetër në këtë fazë është spekulim, përfshirë edhe çështjet që janë ngritur nga ju”.<sup>43</sup>

Pas raporteve mediale një muaj më vonë se kishte takuar Ramën dhe Ali Ahmetin, liderin politik të shqiptarëve në Maqedoni, për të diskutuar ndryshimin e kufijve, Thaçi publikisht e mohoi këtë pretendim, duke theksuar se:

“ide të tilla nuk sjellin paqe dhe stabilitet, ato nuk vijnë nga institucionet e Kosovës. Kjo (ndarja) është çështje e vdekur. Kishte ide për ndarje më parë, por unë kam qenë i qartë: respektimi i integritetit territorial është tejet i rëndësishëm”.<sup>44</sup>

## KONKLUZAT

Mohimi nga Serbia i realitetit politik në terren në Kosovë dhe ndjekja prej saj e një politike virtuale ndaj Kosovës, e cila nuk e pranon seriozisht popullatën shumicë shqiptare as si sovran në Kosovë apo, në vend të kësaj, as si qytetarë, por më shumë i përdor këto për përfitime taktike, ishin në epiqendrën e politikës së Serbisë ndaj Kosovës për shumë dekada. Politika e pandershme dhe zhgënjyese e ka parandaluar çdo iniciativë të Perëndimit për të zgjidhur kontestin rreth statusit mes Serbi-Kosovë në një kornizë klasike të ndërmjetësimit të konfliktit, duke rezultuar kështu me dështim të negociatave të Treshes dhe refuzimin nga Serbia të planit të Ahtisaarit. Ishte ky veprimi i fundit që bindi shumicën e shteteve perëndimore se formalizimi i faktit që Serbia efektivisht e ka humbur Kosovën përmes shpalljes së pavarësisë më 2008 ishte e vetmja zgjidhje e zbatueshme dhe e qëndrueshme për kontestin afatgjatë rreth statusit. Kjo u konsiderua si një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e një të ardhmeje paqësore dhe demokratike për Ballkanin Perëndimor - dhe jo një shkelje e ligjit ndërkombëtar, siç pretendonin disa. Në vitin 2008, e gjithë elita politike e Serbisë ishte e vetëdijshme se Kosova kishte shkuar, dhe nuk kishte asnjë tjetër kujt mund ti atribuohet ky zhvillim përveç aktorëve politik serbë, diskursit të tyre, dhe politikave e veprimeve të tyre. Oportunizmi tradicional i politikës ballkanike i ka parandaluar ata që ta pranojnë këtë të vërtetë të dhimbshme, apo që t’ia komunikojnë qytetarëve të tyre.

Kancelarja Merkel inicoi kthesën e vonuar, e ndjekur nga liderët tjerë të Perëndimit, që i hai rrugë dialogut politik të udhëhequr nga BE-ja.

Duke e vendosur kornizën, përfshier edhe vijat e kuqe strikte, ia mundësoi elitës politike serbe që të lëviz përpara drejt një politike dhe një diskursi publik rreth Kosovës të bazuar në realitet. Më tutje, kjo i lejoi elitave serbe që ta shtyejnë kontestin Kosovë-Serbi drejt një dialogu për nevojat praktike dhe prioritetet legjitime për sigurimin e një jetese normale për serbët e Kosovës në shtetin e Kosovës, normalizim të marrëdhënieve mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, dhe marrëdhënieve bilaterale mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo kornizë ka predikuar që Republika e Kosovës të fitojë integritetin e plotë territorial, sovranitetin dhe subjektivitetin ndërkombëtar. Dhënia fund braktisjes në të cilën edhe Kosova edhe Serbia ishin ngujuar - si shtete të papërfunduara - ishte baza për Kosovën që të hyjë në këtë marrëveshje origjinale. Përkundër brengave të saja rreth ndikimit të Marrëveshjes së Prillit 2013 në integritetin dhe funksionalitetin e shtetit, Kosova mbeti brenda kushteve të dakorduara prej saj.

Për fat të keq, dialogu mbetet në krizë serioze sa i përket kornizës origjinale, vijave të kuqe, dhe synimeve, mbetet pezull pas shpalljes së fazës së re të dialogut dhe nisjes së negociatave rreth një marrëveshjeje finale, gjithpërfshirëse.

Për një të ardhme paqësore dhe demokratike për Kosovën dhe (dhe SHBA-ja) të rikonfirmojnë në mënyrë eksplicite kornizën dhe synimet origjinale të dialogut politik. Do të jetë po aq e rëndësishme që Prishtina të vazhdojë ti përmbahet kushteve fillestare me të cilat edhe ka hyrë në këtë dialog.

